

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Kontabiliteti Financiar
Financial Accounting**

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Kompania private (PC) është në vitin e saj të katërt të operacioneve. Pronari i kësaj kompanie sapo ju ka punësuar juve si kontabilist me orar të plotë dhe ju jeni duke përgatitur pasqyrat financiare të kompanisë të cilat përfundojnë më 31 Dhjetor 2016.

a) Analiza e llogarive të arkëtueshme zbuloi këto informata:

Llogaritë e arkëtueshme – 1 Janar 2016	€450,000
Lejimi për llogaritë e dyshimta – 1 Janar 2016	€20,000
Shitjet me kredi (me afat pagese) gjatë 2016	€1,100,000
Arkëtimet nga klientët gjatë vitit 2016	€1,050,000

Analiza e moshimit të llogarive të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2016 thekson:

1. Gjatë vitit 2016 falimentoi klienti kryesor (DBD) dhe nga ky klient nuk do të ketë më arkëtime të llogarisë së arkëtueshme prej €22,000.
2. Pas regjistrimit në kontabilitet të llogarisë së arkëtueshme nga DBD, moshimi i llogarive të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2016 theksoi se kërkohet një lejim për llogaritë e dyshimta si 5% e saldos së llogarive të arkëtueshme.

Kërkohet:

Përgatitni regjistrimet në ditar apo llogari për të shlyer llogarinë e arkëtueshme të DBD-së dhe për të regjistruar shpenzimet e borxheve të këqija më 2016 dhe poashtu regjistroni edhe rritjen/ zvogëlimin në lejimet për borxhet e dyshimta (përfshini kalkulimet tuaja të shpenzimeve të borxhit të keq).

b) Analizat e stokeve zbuluan se saldo përfundimtare e stokeve në fund të vitit 2015 ishte mbivlerësuar me €15,000 si rezultat i një gabimi në numërimin fizik të stokeve. Stoket në fund të vitit 2016 janë kalkuluar saktësisht.

Kërkohet:

Tregoni efektet e gabimit (nëse ka) në secilën nga elementet në vijim. Gjithashtu theksoni nëse secila nga elementet në vijim do të mbivlerësohet, nënvlerësohet apo nuk do të jetë e ndikuar (si dhe shumat përkatëse).

- i) fitimi neto i vitit 2015
- ii) kosto e mallrave të shitura për vitin 2016
- iii) Fitimi i mbajtur i datës 31 Dhjetor 2016

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit 1

- a)
i) Shpenzimet e borxheve të këqija 22,000
Llogaritë e arkëtueshme 22,000

ii) **Llogaritë e arkëtueshme**

Saldo fillestare	€450,000	Arkëtimet nga klientët	1,050,000
Shitjet me kredi	<u>€1,100,000</u>	Saldo balancuese (përfundimtare)	<u>€500,000</u>
Totali	<u>€1,550,000</u>	Totali	<u>€ 1,550,000</u>

Lejimet për borxhet e dyshimta në fund= $(500,000-22,000)*5\%=23,900$

Lejimet për borxhet e dyshimta

Saldo balancuese(përfundimtare)	<u>€23,900</u>	Saldo fillestare	€20,000
		Shpenzimet e borxheve të dyshimta(shifër ekuilibruese)	<u>€3,900</u>
Totali	<u>€ 23,900</u>	Totali	<u>€ 23,900</u>

- Shpenzimet e borxhit të dyshimta..... 3,900
Lejimi për llogaritë e dyshimta..... 3,900

Shpenzimet e borxheve të këqija dhe të dyshimta= $22,000+3,900=25,900$

- b)
i) fitimi neto i vitit 2007 do te mbivlerësohet për €15,000.
ii) kosto e mallrave te shitura do te mbivlerësohet për €15,000.
iii) Fitimi i mbajtur më 31 Dhjetor 2008 nuk do të ndikohet pasi që gabimi i vitit 2007 do të kthehet mbrapsht gjatë vitit 2008.

Problemi 2

(i)

(a) Përshkruani se cilat janë kostot që mund të kapitalizohen dhe njihen si kosto e pasurive jo-qarkulluese në bazë të SNK 16 Pasuritë e Patundshme, Impiantet dhe Pajisjet -

(4 pikë)

(b) Duke u bazuar në SNK 16, tregoni trajtimin dhe bëni regjistrimet e nevojshme në konto T për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2009 dhe në atë që përfundon më 31 Dhjetor 2010 duke u bazuar në informatat e mëposhtme.

- Toka (pasuri që nuk zhvlerësohet) e cila kishte kushtuar 300,000 € ishte rivlerësuar më 31 Dhjetor 2009 dhe kishte një vlerë prej 400,000 €.
- E njëjta pasuri (Toka) është rivlerësuar më 31 Dhjetor 2010 dhe kishte një vlerë prej 250,000.

(6 pikë)

(ii) Llogariteni zhvlerësimin për kompaninë Minerali për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2010 duke u bazuar në informatat e mëposhtme :

Minerali Sh.p.k ka blerë një ndërtesë më 1 Janar 2005 me vlerë 500,000 €. Ndërtesa është zhvlerësuar me normë vjetore 5% me metodën drejtvizore. Më 1 Janar 2010 ndërtesa është rivlerësuar në 800,000 €, po ashtu vlerësuesi kishte llogaritur se vlera mbetëse do të jetë 200,000 €. Jeta ekonomike e pasurisë nuk ka pësuar ndonjë ndryshim në rastin e rivlerësimit.

(4 pikë)

(iii)

Llogariteni Saldon përfundimtare të Llogarisë kontrolluese të Arkëtueshme duke shfrytëzuar informatat relevante nga të dhënat e poshtë shënuara:

Saldo Fillestare e Llogarive të Arkëtueshme	156,748.55 €
Shitjet me kredi	847,831.32 €
Blerjet me kredi	523,456.28 €
Kthimet nga blerjet me kredi	8,548.38 €
Kthimet nga shitjet me kredi	5,489.25 €
Zbritjet e lejuara	2,758.22 €
Zbritjet e marra (pranuara)	1,689.88 €
Regjistrimet kontra (Kundërhyrjet)	856.58 €
Paraja e arkëtuar nga shitjet me kredi	760,449.82 €

(10 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit 2

(i) (a) Kostot të cilat mund të kapitalizohen dhe të kalojnë si Pasuri jo-qarkulluese në Pasqyrën e Pozitës Financiare janë :

- Çmimi i saj blerjes, përfshirë taksat doganore dhe taksat e pakthyeshme të blerjes, pasi zbriten zbritjet tregtare
- Çdo kosto të ngarkueshme drejtpërdrejt me sjelljen e pasurisë në vendin dhe për plotësimin e kushteve e nevojshme që ajo pasuri të jetë e aftë të funksionojë në mënyrën e synuar
- Vlerësimi fillestar i kostove të zbrërthimit dhe heqjes së zërit dhe restaurimin e ambientit në të cilën është vendosur, detyrimi për të cilën një pushtohet nga njësi ekonomike ose kur elementi është blerë ose si pasojë e duke përdorur pika gjatë një periudhe të caktuar për qëllime të tjera sesa për të prodhuar inventarëve gjatë se periudhë.

(i)(b)

Regjistrimet sa i përket rivlerësimeve do të jenë :

Në fund të vitit 2009

<i>Debi</i> Pasuritë jo-qarkulluese-Toka	100,000 €
<i>Kredi</i> Rezerva e rivlerësimit	100,000 €

Në fund të vitit 2010

<i>Debi</i> Rezerva e rivlerësimit	100,000 €
<i>Debi</i> Humbja na renia në vlerë e Tokës	50,000 €
<i>Kredi</i> Pasuritë jo-qarkulluese-Toka	150,000 €

(ii)

Duke pasur parasysh që norma vjetore e zhvlerësimit është 5% , kjo nënkupton që jeta ekonomike e kësaj pasurie është $100\%/5\% = 20$ vite.

Pasuria është blerë 1 Janar 2005 do të thotë që para rivlerësimit është përdorur 5 vite dhe kanë mbetur edhe 15 vite jetë ekonomike për këtë pasuri.

Zhvlerësimi vjetor do të llogaritet si :

$$(800,000-200,000)/15 \text{ vite} = 40,000\text{€}$$

(iii)

Llogaria kontrolluese e të Arkëtueshmeve

S'	5,489.25	Kth. E
156,748.55	shitjeve	
Shitjet me kr. 847,831.32	2,758.22	Zbritjet e lejuara
	856.58	Regj.Kontra
	760,449.82	Paraja e
	ark.	
	235026	saldo t/m
s" 235026		

Problemi 3

Znj.Rina zotëron dhe drejton dyqanin e saj të furnizimeve të produkteve bujqësore Rina Sh.P.K. Ajo përdorë një marzhë prej 50% shtim mbi kosto për të gjitha produktet që ajo shet. Megjithatë, regjistrimi i të dhënave është i mangët. Pas investigimit, informatat e mëposhtme ju janë dhënë juve:

Përmbledhja e Pasurive dhe Detyrimeve më 31 dhjetor 2015 (p.sh. saldot në fund nga viti paraprak)

Pasuritë Jo-Qarkulluese	70,000
Stoqet	20,000
Paraja e gatshme në dorë	1,000
Paraja e gatshme në bankë	3,800
Llogaritë e pagueshme	3,600
Ekuiteti (Fitimet e mbajtura 51,200; Kapitali i pronarit 40,000)	91,200

Në vitin deri më 31 dhjetor 2016:

1. Nuk kishte shitje me afat pagese.
2. Nga totali i shitjeve në para të gatshme, 156,500€ prej tyre u depozituan në bankë dhe pjesa tjetër kishte mbetur në arkën e parave të vogla (Petty Cash).
3. Pagesat e mëposhtme u bënë nga paraja e gatshme në bankë:

Llogaritë e pagueshme	130,000
Riparimi dhe Mirëmbajtja	8,000
Sigurimi	4,800
Dritat dhe Ngrohja	6,000
Sigurimi për shtëpinë personale të Rinës	1,000
4. Pagesat e mëposhtme u bënë nga paraja e gatshme në dorë:

Llogaritë e pagueshme	6,800
Pagat	30,000
Tërheqjet	10,800
5. Saldo në fund e parasë së gatshme në dorë ishte 900€ dhe saldo në fund e llogarive të pagueshme ishte 4,200€. Të gjitha blerjet nga llogaritë e pagueshme lidhen me blerjen e stoqeve.
6. Shpenzimet e zhvlerësimit për vitin ishin 3,000€.
7. Saldo në fund e parasë së gatshme në bankë dhe stoqeve në fund nuk dihet.

KËRKOHET:

Përgatitni

- a) Pasqyrën e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016. (12 pikë)
- b) Pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2016. (8 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja(3)

Banka

Saldo ne fillim	3,800	LL/P	130,000
Shitjet	156,500	Riparimi dhe mirëmbajtja	8,000
		Sigurimi	4,800
		Dritat dhe ngrohja	6,000
		Terheqja e pronarit	1,000
Saldo ne fund		10,500	

Paraja e gatshme ne dore(Petty cash)

Saldo ne fillim	1,000	LL/P	6,800
Shitjet(shifer bal)	47,500	Pagat	30,000
		Terheqjet	10,800
Saldo ne fund		900	

Gjithsej shitjet= 156,500+47,500=204,000

Shitjet	150%	204,000		204,000
			Pra, $204,000/1.5 =$	
Kosto e shitjeve	<u>100%</u>	?	K.Shitjeve	<u>136,000</u>
Fitimi bruto	<u>50%</u>	?		<u>68,000</u>

Llogaria e të pagueshmeve
tregtare

Pagesat nga banka	130,000	Saldo balancuese s/b	3,600
Pagesat në para të gatshme	6,800	Blerjet - Saldo balancuese	137,400
Saldo në fund s/f	<u>4,200</u>		
	<u>141,000</u>		<u>141,000</u>
Kosto e shitjeve			
Stoqet në fillim	20,000		
+ Blerjet	137,400		
- Stoqet në fund	X		
= Kosto e shitjeve	136,000		
$20,000 + 137,400 - X =$	136,000		
$X = 21,400$			

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve "Rina sh.p.k" për vitin që mbaron më 31 dhjetor 2016

	!	!	!
Të hyrat			204,000
Kosto e shitjeve			
Stoqet në fillim		20,000	
+ Blerjet		137,400	
- Stoqet në fund		<u>- 21,400</u>	
Kosto e shitjeve në total			<u>136,000</u>
Fitimi Bruto			68,000
Shpenzimet			
Shpenzimet e mirëmbajtjes		8,000	
Sigurimi		4,800	
Drita & Ngrohje		6,000	
Pagat		30,000	
Zhvlerësimi		<u>3,000</u>	
Total Shpenzimet			51,800
Fitimi / Humbja neto			<u><u>16,200</u></u>

TOTAL PIKËT 12

b) Pasqyra e pozitës financiare për “Rina sh.p.k” më 31 dhjetor 2016

Pasuritë jo-qarkulluese		
PIP	67,000	(70,000 - 3,000)
Total pasuritë jo-qarkulluese		67,000
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	21,400	
Paraja e gatshme & Ekuivalentët	11,400	(10,500 + 900)
Total pasuritë qarkulluese		32,800
Total pasuritë		99,800
Ekuiteti & Detyrimet		
Ekuiteti		
Ekuiteti	40,000	
Tërheqjet	-	(10,800 + 1,000)
Fitimi i mbajtur	67,400	(51,200 + 16,200)
Total ekuitet		95,600
Detyrimet afatgjata		
Total detyrimet afatgjata		-
Detyrimet afatshkurtra		
Llogaritë e pagueshme	4,200	
Total detyrimet afatshkurtra		4,200
Total Ekuiteti & Detyrimet		99,800

Problemi 4

Sing ka blerë 80% të ekuitetit të Kit më 1 janar 2016 për 120,000€ kur fitimet e mbajtura të Kit ishin 50,000€. Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në atë datë ishte 40,000€. Gjatë vitit Sing i shiti Kit-it mallra që kushtonin 80,000€, me një kosto të faturuar prej 100,000€. Kit kishte 50% të mallrave ende në stoqe në fund të vitit. Draft pasqyrat financiare të dy kompanive më 31 dhjetor 2016 janë si vijon:

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2016

	<i>Sing</i>	<i>Kit</i>
	€000	€000
Të hyrat	5,000	1,000
Kosto e shitjeve	<u>2,900</u>	<u>600</u>
Fitimi bruto	2,100	400
Shpenzimet e tjera	<u>1,700</u>	<u>320</u>
Fitimi para tatimit	400	80
Tatimi	<u>130</u>	<u>25</u>
Fitimi i vitit	<u><u>270</u></u>	<u><u>55</u></u>

PASQYRA E POZITËS FINANCIARE MË 31 DHJETOR 2016

	<i>Sing</i>	<i>Kit</i>
	€'000	€ '000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Investimet në Kit	120	-
Pasuritë jo-qarkulluese të prekshme	1,880	200
	<u>2,000</u>	<u>200</u>
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	500	120
Llogaritë e arkëtueshme	650	40
Paraja në bankë	<u>390</u>	<u>35</u>
	<u>1,540</u>	<u>195</u>
	<u><u>3,540</u></u>	<u><u>395</u></u>
<i>Ekuiteti dhe Detyrimet</i>		
<i>Ekuiteti</i>		
Kapitali aksionar	2,000	100
Fitimi i mbajtur	<u>400</u>	<u>200</u>
	2,400	300
<i>Detyrimet afatshkurta</i>		
Llogaritë e pagueshme	910	30
Tatimi	<u>230</u>	<u>65</u>
	<u>1,140</u>	<u>95</u>
	<u><u>3,540</u></u>	<u><u>395</u></u>

Kërkohet

Përgatitni draft pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe draft pasqyrën e pozitës financiare të Grupit Sing më 31 dhjetor 20X8.

(Totali 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

GRUPI SING

PASQYRA E KONSOLIDUAR E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR FITIN QË MBARON MË 31 DHJETOR 20X8

	€'000
Të hyrat (5,000 + 1,000 - 100*)	5,900
Kosto e shitjeve(2,900 + 600 - 100* + 10(LL2))	<u>3,410</u>
Fitimi bruto	2,490
Shpenzimet e tjera (1,700 + 320)	<u>2,020</u>
Fitimi para tatimit	470
Tatimi (130 + 25)	<u>155</u>
Fitimi i vitit	<u>315</u>
<i>Fitimi i atribuohet:</i>	
Mbajtësve të ekuitetit të kompanisë mëmë (sh.bal.)	304
Interesi jo-kontrollues (20% × €55,000)	<u>11</u>
	<u>315</u>

* Largo tregtinë brenda grupit

PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZITËS FINANCIARE MË 31 DHJETOR 20X8

	€'000	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Zëri i mirë (LL1)	10	
Pasuritë jo-qarkulluese të prekshme (1,880 + 200)	<u>2,080</u>	
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet (500 + 120 - 10(LL2))	610	
Llogaritë e arkëtueshme (650 + 40)	690	
Paraja në bankë (390 + 35)	<u>425</u>	
		<u>1,725</u>
		<u>3,815</u>
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>		
<i>Ekuiteti që i takon mbajtësve të kompanisë mëmë</i>		
Kapitali aksionar (vetëm Sing)		2,000
Fitimi i mbajtur (LL3)		<u>510</u>
		2,510
Interesi jo-kontrollues (LL4)		<u>70</u>
Total ekuiteti		2,580

Detyrimet afatshkurtra

Llogaritë e pagueshme (910 + 30) 940

Tatimi (230 + 65) 295

1,235

Total ekuiteti dhe detyrimet

3,815

Llogaritjet

1 Zëri i mirë

	€'000	€'000
Vlera e drejtë e konsideratës së transferuar		120
Plus vlera e drejtë e IJK-së në blerje		40
Minus vlera e drejtë neto e pasurive të identifikueshme të blera të përfaqësuara nga:		
Kapitali aksionar	100	
Fitimet e mbajtura	<u>50</u>	
		<u>(150)</u>
Zëri i mirë		<u>10</u>

2 Kalkulimi për fitimin e porealizuar

	€
Fitimi nga tregtia brenda grupit (100,000 - 80,000)	20,000
Fitimi i pa-realizuar (50% × 20,000)*	10,000
* 50% e mallrave nga tregtia brenda grupit mbetet në stoqe në fund të vitit, për këtë arsye fitimi i pa-realizuar është 50% e fitimit total nga tregtia brenda grupit. Pjesa tjetër e fitimit nga tregtia brenda grupit realizohet tani pasi që mallrat janë shitur jashtë grupit.	

3 Fitimet e mbajtura

	Sing €'000	Kit €'000
Sipas pyetjes	400	200
Fitimi i pa-realizuar (W2)	(10)	
Fitimet e mbajtura para blerjes		<u>(50)</u>
		<u>150</u>
Pjesa e grupit e fitimeve të mbajtura pas blerjes:		
Kit (80% × 150)	<u>120</u>	
Fitimet e mbajtura të grupit	<u>510</u>	

4 Interesi jo-kontrollues në datën e raportimit

	€'000
Vlera e drejtë e IJK-së në datën e blerjes	40
Plus pjesa e IJK-së e fitimeve të mbajtura pas blerjes (20% × 150)	<u>30</u>
IJK në datën e raportimit	<u>70</u>

Problemi 5

Frashër Sh.P.K. operon në industrinë e prodhimit të produkteve bujqësore dhe pasqyrat financiare të kësaj ndërmarrje janë si më poshtë:

Frashër Sh.P.K. Pasqyra e Pozitës Financiare më 31 dhjetor 2016

	2016	2015
	'000 €	'000 €
Pasuritë Jo-Qarkulluese		
Prona, Fabrika dhe Pajisjet	5,120	3,940
Total Pasuritë Jo-Qarkulluese	5,120	3,940
Pasuritë Qarkulluese		
Stoqet	1,380	1,220
Llogaritë e arkëtueshme	780	680
Keshi dhe ekuivalentët e tij	50	112
Total Pasuritë Qarkulluese	2,210	2,012
TOTAL PASURITË	7,330	5,952
EKUITETI DHE DETYRIMET		
EKUITETI		
Kapitali aksionar	240	200
Premia e aksioneve	60	50
Fitimi i mbajtur	3,798	2,402
Rezerva e rivlerësimit	120	80
Total Ekuiteti	4,218	2,732
Detyrimet Afatgjata		
Kredia afatgjatë	1,500	1,600
Total Detyrimet Afatgjata	1,500	1,600
Detyrimet Afatshkurtra		
Llogaritë e pagueshme	1,470	1,500
Overdrafti bankar	32	60
Tatimi i pagueshëm	110	60
Total Detyrimet Afatgjata	1,612	1,620
TOTAL EKUITETI DHE DETYRIMET	7,330	5,952

Shënimet shtesë:

- i. Fitimi para tatimit për vitin ishte 1,476,000€.
- ii. Shpenzimet e tatimit për vitin ishin 80,000€.
- iii. Kosto e Pronës, Fabrikës dhe Pajisjeve më 01 janar 2016 ishte 4,860,000€. Politikë e kompanisë është zhvlerësimi i të gjitha pasurive me normën 20% sipas metodës drejtvizore (lineare), duke e aplikuar nga data e blerjes deri në datën e shitjes. Blerja shtesë e Pronës, Fabrikës dhe Pajisjeve ndodhi më 31 dhjetor 2016. Më 1 korrik 2016, kompania shiti një pasuri në kuadër të Pronës, Fabrikës dhe Pajisjeve e cila kishte kosto historike 1,000,000€. Në datën kur kjo pasuri u shit, vlera neto në libra e kësaj pasurie ishte 600,000€ duke bërë kështu që kompania të ketë një humbje kapitale nga shitja në vlerë prej 40,000€. Rivlerësimi i Pronës, Fabrikës dhe Pajisjeve ishte kryer më 31 dhjetor 2016.
- iv. Shpenzimet e interesit për vitin ishin të barabarta me shumën e interesit të paguar gjatë vitit në vlerë prej 92,000€.

KËRKOHET:

Përgatitni Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë së Gatshme për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016 për ndërmarrjen Frashër Sh.P.K. në pajtueshmëri me SNK 7 Pasqyra e Rrjedhës së Parasë.

Totali 20 pikë

Zgjidhja e problemit 5

Frashër Sh.P.K.		
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë së Gatshme për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016		
	'000 €	'000 €
I. AKTIVITETI OPERATIV		
Fitimi para tatimit	1,476	
Korrigjimet për:		
Shpenzimet e zhvlerësimit	+ 872	
Humbja nga shitja e P.F.P.	+ 40	
Shpenzimet e interesit	<u>+ 92</u>	
	2,480	
Rritja në stoqe	- 160	
Rritja në llogaritë e arkëtueshme	- 100	
Zvogëlimi në llogaritë e pagueshme	<u>- 30</u>	
<i>Paraja e gatshme e gjeneruar nga operacionet</i>	2,190	
Pagesa e interesit	- 92	
Pagesa e tatimit	<u>- 30</u>	
Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktiviteti operativ		2,068
II. AKTIVITETI INVESTUES		
Pagesat për blerjen e P.F.P.	- 2,612	
Paraja e pranuar nga shitja e P.F.P	<u>+ 560</u>	
Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktiviteti investues		- 2,052

III. AKTIVITETI FINANCUES		
Paraja e pranuar nga emetimi i aksioneve	+ 50	
Pagesat e bëra për zvogëlimin e kredisë	<u>-100</u>	
Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktiviteti financues		- 50
Rrjedha neto e parasë së gatshme gjatë vitit		- 34
Keshi dhe ekuivalentët e keshit në fillim të vitit (112 - 60)		52
Keshi dhe ekuivalentët e keshit në fund të vitit (50 - 32)		18